

## **SHPLLJE KONKURSI PËR DREJTOR INSTITUCIONI ARSIMOR NË KOPSHTIN PAPËR, NJËSIA ADMINISTRATIVE PAPËR, BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të ligjit nr.48 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar neni 15, dhe udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit public të arsimit parauniversitar”, Bashkia Elbasan shpall konkurs për drejtues të institucionit arsimor parashkollor në kopshtin Papër, Njësia Administrative Papër, bashkia Elbasan.

### **1.1 KUSHTET DHE KRITERET E VECANTA PËR KONKURIM**

**Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për drejtor i institucionit të arsimit parashkollor publik janë:**

- a) Të zotërojë diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor” të formimit për mësues të arsimit parashkollor ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- b) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune si mësues i arsimit parashkollor;
- c) Të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
- d) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore apo i rehabilituar për këto vepra penale;

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Dokumentat që duhet të dorëzojë kandidati për drejtor i institucionit të arsimit parashkollor publik janë:**

- a) Jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të , sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.1, në udhëzimin nr.2/2020;
- b) Kopjen e njësuar me origjinalin të diplomës së shkollës së lartë bashkë me listën e notave ; *e detyrueshme*
- c) Kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;
- d) Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- e) Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, në udhëzimin nr.2/2020; *e detyrueshme*
- f) Dëshminë e penalitetit të lëshuar jo më herët se 3 muaj para datës së aplikimit; *e detyrueshme*
- g) Vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi; *e detyrueshme*
- h) Deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të institucionit publik të arsimit parashkollor (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.3, në udhëzimin nr.2/2020. *e detyrueshme*

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet **nëpërmjet shërbimit postar në Bashkinë Elbasan**, jo më vonë se **5 ditë** pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë të punës për drejtor të institucionit të arsimit parashkollor publik.

### **1.3 KRITERET MBI TË CILAT DO TË BËHET VLERËSIMI I KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin e dorëzuar në lidhje me:**

- a) Notën mesatare të studimeve të larta;
- b) Vlerësimin e provimit të kualifikimit;
- c) Dëshminë/të e njohjes së gjuhëve të huaja;
- d) Certifikata trajnimesh me kredite;
- e) Vjetërsi pune në arsim;
- f) Vjetërsi pune si drejtuese;
- g) Studime pasuniversitare;
- h) Shkrime për çështje të drejtimit të institucionit parashkollor;
- i) Intervista e strukturuar;

### **DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për konkurim do të marrin informacion në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan, për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit si dhe për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista me gojë .

Të gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail ne CV )